



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 31, DATË 22.04.2020

**MBI SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SUBJEKTIT PERSON FIZIK
ERION SEFAJ PËR MARRJE AUTORIZIMI PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT
TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJET
KABLLOR "3ENET"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve me:

Kërkues: Subjekti person fizik Erion Sefaj.

Objekt: Shqyrtimi i aplikimit të subjektit person fizik Erion Sefaj, për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "3ENET".

Baza Ligjore: Nenet 19, pika 16, neni 64, pika 5 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe neni 14, pikat 2 dhe 3 të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

VËREN:

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, neni 55 pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s nr. 99, datë 07.06.2017, subjekti person fizik Erion Sefaj, paraqiti aplikimin nr. 4564 prot., datë 26.12.2019, për marrje autorizimi të subjektit audioviziv privat "3ENET", në zonën "Njësia administrative Prezë".

Në zbatim të urdhrit nr. 331, datë 30.12.2019, të Kryetarit të AMA-s, në datën 30.12.2019, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) për të shqyrtuar aplikimin e depozituar nga ky subjekt. Përpara plotësimit të afatit 30 ditor, AMA njoftoi subjektin me shkresat nr. 4400/1 datë 31.12.2019 dhe nr. 400/1 prot., datë 05.02.2020, se aplikimi është në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit dhe subjekti do të njoftohej në një kohë të dytë mbi vendimmarrjen e AMA-s.

KSHD, konstaton se aplikimi i subjektit person fizik Erion Sefaj, për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "3ENET", është me të meta në dokumentacion pasi nuk përmbush kërkesat financiare.

Konkretisht nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se:

- Të dhënat për kapitalin financiar si dhe plani ekonomik financiar janë depozituar fotokopje, pra jo në formën e kërkuar, origjinal ose kopje e njësuar me origjinalin, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në rregullore, për kapitalin financiar.

Neni 64, pika 5 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se: "Refuzimi i aplikimi bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar."

Neni 14 i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, përcakton se: 2. "AMA vendos për aplikimin e depozituar brenda 30 ditëve nga depozitimi i aplikimit, të plotësuar me të gjitha kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje, për autorizim. Nëse AMA nuk shprehet zyrtarisht brenda këtij afati, autorizimi konsiderohet i miratuar." 3. "Pika 2 e këtij neni nuk zbatohet për aplikimet të cilat rezultojnë me të meta dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe ato të kësaj rregulloreje."

Sa më sipër, AMA arrin në përfundimin se aplikimi i subjektit person fizik Erion Sefaj, për marrje autorizimi për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "3ENET", nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 64, pika 5 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 14 pikat 2 dhe 3 të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Erion Sefaj, për marrje autorizimi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "3ENET", për shkak të mangësive të dokumentacionit.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA